

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera –
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 67/2021

Datë: 28.10.2021

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4. të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr këtë:

V E N D I M

mbi

**caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjeshëm të masës 2.4 - Mbështetja e
Eksportit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike**

A. FORMA E SUBVENCIONIMIT

1. Mbështetja financiare e eksportit për bizneset prodhuese dhe përpunuese bëhet në formën si në vijim:
 - 1.1. Subvencionimi deri në 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) për ngritjen e kapaciteteve të stafit menaxherial të biznesit prodhues dhe përpunues, për trajnim, shkollim, dhe/apo certifikim profesional;
 - 1.2. Subvencionimi deri në 20,000.00 € (njëzet mijë euro) për ngritjen e kapaciteteve të stafit të biznesit të angazhuar në procesin e prodhimit dhe përpunimit;

1.3. Subvencionimi deri në 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro) për aktivitetet që lidhen me brendimin, ribrendimin dhe marketingun e produkteve të biznesit prodhues dhe përpunues; dhe

1.4. Subvencionimi deri në 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro) për pjesëmarrje në panairë jashtë vendit, si mundësi për gjetjen e tregjeve të reja për eksport.

B. KRITERET PËR SUBVENCIONIM

2. Subvencionimi sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për të gjitha bizneset të cilat i plotësojnë kriteret si në vijim:

2.1. Veprimtaria e biznesit duhet të bëjë pjesë tek bizneset prodhuese dhe/apo përpunuese; dhe

2.2. Mjetet financiare nga subvencioni të shfrytëzohen për qëllime të rritjes së cilësisë së produkteve dhe shtimit të veprimtarisë së biznesit, në përputhje me qëllimin e masës 2.4;

3. Kriteret e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

C. KUFIZIMET NË SUBVENCIONIM

4. Vlera e subvencionit nga ky vendim do të përcaktohet në përputhje me numrin e punëtorëve aktualë dhe kapaciteteve prodhuese të biznesit.

D. APLIKIMI PËR SUBVENCIONIM

5. Aplikimi për të përfituar nga masa 2.4 bëhet në mënyrë elektronike, përmes plotësimit të aplikacionit elektronik për të cilin Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve obligohet që në kohë optimale nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ta zhvillojë dhe ta publikojë.

E. APROVIMI DHE FINALIZIMI I LISTËS SË PËRFITUESVE

6. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes një vendimi të veçantë, themelon një Komision në kuadër të Ministrisë për aprovimin e listës së përfituesve.

7. Lista finale e të kualifikuarve si përfitues nga subvencionimi sipas këtij vendimi konfirmohet nga Komisioni i përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Lista finale me të dhënat e përfituesve dhe shumën totale të aprovuar, pas regjistrimit të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës procedohet tek Thesari për ekzekutim.


F. ZBATIMI I VENDIMIT PËR SUBVENCIONIM

9. Pas aprovimit të listës së përfituesve, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogaritë bankare të përfitueseve.
10. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

G. HYRJJA NË FUQI

11. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hekuran Murati


Ministëri i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi i'u dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; dhe
- Arkivit të MFPT-së.